

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6236
E mërkurë, 10 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

9 382 foshnja u
mjekuan në Klinikën
e Neonatologjisë Faqe 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



INTERVISTË ME HISTORIANIN E NJOHUR FRANCEZ SERGE MÉTAIS Faqe 4-5

KUVENDI I KOSOVËS ME LIGJ MUND TA ZHBËJË GJYKATËN SPECIALE

MOSRESPEKTIKI I MASAVE KUNDËR COVIDIT NGA
PARITË POLITIKE KA NXITUR REAGIME TË SHUMTA

FUSHATA ZGJEDHORE PO PARAQET RREZIK PËR SHËNDETIN PUBLIK

Avokati i Popullit, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Demokracia në Veprim (DnP) dhe Federata e Sindikatave e Shëndetësisë së Kosovës (FSShK), kanë kritikuar partitë politike për mosrespektim të masave kundër Covidit gjatë fushatës zgjedhore. Këto institucione kanë vlerësuar se tubimet e partive politike po rrezikojnë shëndetin e popullatës në përgjithësi dhe të punëtorëve shëndetësorë në veçanti. Sipas tyre, mosreagimi i institucioneve që kanë për obligim t'i zbatojnë këtë masa, është standard i dyshtë që cenon barazinë e qytetarëve para ligjit Faqe 3



Historiani i njohur francez Serge Métais, në një intervistë botuar në "Mediapart" në Francë, ka thënë se Gjykata Speciale nuk është krijuar nëpërmjet ndonjë rezolute të Kombeve të Bashkuara. Sipas tij, ajo nuk është ngritur as nëpërmjet ndonjë traktati mes shteteve. "Ajo është një institucion i Republikës së Kosovës. Është krijuar me një ligj të votuar nga Kuvendi i Kosovës. Gjithçka që është e bërë me ligj, mund të zhbëhet me ligj. Nuk ka asnjë mekanizëm institucional mbishtetëror që të mund ta pengojë shkrirjen e Gjykatës së Posacmë dhe transferimin e dosjes së akuzës te gjykatat e Kosovës në Prishtinë. Dhe kjo, që nga momenti në të cilin Kuvendi i Kosovës do të votonte një ligj në këtë drejtim", ka thënë Métais



NËSE LV-JA NUK E FITON
SHUMICËN ABSOLUTE, NUK
DO TA BËJË AS QEVERİNË! F. 11

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORÀ



AKTUALE



AMBASADORI MINXHOZI
PREMTON PËRKRAHJE PËR
AGJENCINË SHTETËRORE TË
ARKIVAVE TË KOSOVËS F. 6

QEVERIA DO TË NDAJË
578 MIJË EURO PËR RIPARIM
TË PROTEZAVE PËR
INVALIDËT E UÇK-së F. 3

AKTUALE

ATK-ja: GJATË MUAJIT JANAR
BIZNESEV U JANË SHQIPTUAR
130 GJABA F. 8

FILLON SHPËRNDARJA
E 20 MILIONË EUROVE
PËR 19 000 FERMERË F. 8

SPORT

PRISHTINA, LLAPI DHE DRENICA
KUALIFIKOHEN NË ÇEREKFINALE



F. 12

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqci - Tetovë Curë - Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Shaip Kamberi mban fjalimin e parë shqip në Kuvendin e Serbisë

Beograd, 9 shkurt - Deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, e ka mbajtur fjalimin e parë në gjuhën shqipe në Kuvendin e Serbisë së pasluftës. Fjalimi i tij ka ndodhur një ditë pasi Gjykata e Lartë në Beograd ka refuzuar ta shpallë fajtor ministrin serb të mbrojtjes,

Aleksandër Vulin, për diskriminim, fyerje dhe gjuhë të urrejtjes ndaj shqiptarëve. Me këtë rast, deputeti Kamberi ka thënë se gjykata i ka dhënë tashmë edhe fuqi juridike institucionalizimit të gjuhës së urrejtjes, mosdurimit dhe ksenofobisë ndaj shqiptarëve.



Rrugët e Parosit zhyten nën ujë

PARIS, 9 SHKURT - Lumi i Senës ka dalë tashmë edhe mbi rrugët e Parosit duke mbuluar me ujë rrugët përgjatë tij në Ile Saint Louis dhe Ile de la Cite. Niveli i ujit tashmë i ka kapërcyer 4.50 metrat, por ekspertët thonë se në ditët në vijim mund të nisë stabilizimi i situatës. E gjithë Franca jugperëndimore është goditur nga përmbytje të rënda të hënën, pas

ditësh të tëra shira të rrëmbyeshëm dhe disa rajone, përfshirë Parisin, mbeten nën alarm nga përmbytjet, ndërkohë që janë në prite të valës së të ftohit që pritet të mbërrijë më vonë këtë javë. Qindra persona janë evakuuar në shumë zona, përfshirë bordonë, ku lumi Charente ka shënuar një nivel rekord prej 6.20 metrash.

Ekipi i OBSh-së: E pamundur që koronavirusi të ketë dalë nga laboratori

GENEVË, 9 SHKURT - Një ekip i ekspertëve ndërkombëtarë që po heton originën e koronavirusit, e hodhi poshtë teorinë që ai të ketë dalë nga laboratori. Peter Ben Embarek, udhëheqës i misionit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ka thënë se “është jashtëzakonisht e pamundur” që koronavirusi të ketë dalë nga një laboratori në qytetin Vuhan të Kinës. Ai tha se duhet bërë më shumë punë për ta identifikuar burimin e tij. Komentet u bënë në përfundim

të një misioni të përbashkët të OBSh-së dhe Kinës. Vuhani, i cili ndodhet në provincën perëndimore Hubei të Kinës, është vendi i parë në botë ku është zbuluar koronavirusi, në fund të vitit 2019. Që atëherë, mbi 106 milionë njerëz janë infektuar në të gjithë botën dhe mbi 2.3 milionë kanë vdekur. Spekulimet janë shfaqur herët në pandemi se virusi mund të kishte dalë aksidentalish nga laboratori, megjithëse nuk ka pasur prova të sigura për ta

mbështetur atë teori. Dr. Embarek tha në një konferencë për media se hetimet kanë zbuluar edhe informacione të tjera, por nuk e kanë ndryshuar imazhin e shpërthimit. Ekspertët besojnë se virusi ka të ngjarë ta ketë originën te kafshët, por nuk janë të sigurt se si.

Liang Wannian, ekspert nga Komisioni Shëndetësor i Kinës, tha se koronavirusi mund të ketë qenë në rajone të tjera përparrë se të zbulohet në Vuhan.



Azerbajxhani e padit Armeninë për konfliktin në Nagorno Karabak

BAKU, 9 SHKURT - Azerbajxhani e ka paditur Armeninë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut (ECHR). Akuzat kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë okupimit gati 30-vjeçar të rajonit Nagorno Karabak.

Padia ka të bëjë edhe me konfliktin e armatosur 44-ditor në fund të vitit të kaluar midis Azerbajxhanit dhe Armenisë.

Një anëtar i Parlamentit të Azerbajxhanit, Kamal Cafarov, tha më 8 shkurt se Jerevani është akuzuar edhe



për mos ndërmarrjen e masave në zbulimin e rreth 3 800 shtetasve të Azerbajxhanit që u zhdukën gjatë një lufte në vitet e 1990. Azerbajxhani në padinë ndaj Armenisë ka ngritur edhe çështjen e përdorimit të

raketave balistike dhe municioneve tjera të rënda gjatë bombardimeve në fund të vitit të kaluar në qytetet dhe fshatrat e Azerbajxhanit. Bazuar në pretendimet e azaerbajxhanasve, nga këto bombardime kanë vdekur 93 civilë, përfshirë 12 fëmijë dhe 28 gra, ndërsa 423 civilë janë plagosur si dhe ka pasur dëme të mëdha materiale. Nagorno Karabaku i përket Azerbajxhanit, por territori i tij dhe shtatë rajonet përreth, që nga fillimi i viteve '90-ta, deri në fillim të nëntorit u kontrolluan nga forcat etnike

armene. Të dyja palët janë përlleshur vazhdimisht, por në shtator, Azerbajxhani filloj një ofensivë ushtarake që rezultoi me marrjen nën kontroll të rajoneve përreth dhe disa pjesëve të vetë Nagorno Karabakut. Palët ranë dakord për një armëpushim të ndërmjetësuar nga Rusia më 10 nëntor. Marrëveshja parashihet edhe vendosjen e 2.000 forcave paqeruajtëse ruse në zonën e konfliktit. Armenia nuk e ka komentuar zyrtarisht padinë e Azerbajxhanit.

Mosrespektimi i masave kundër Covidit nga paritë politike ka nxitur reagime të shumta

Fushata zgjedhore po paraqet rrezik për shëndetin publik

Avokati i Popullit, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Demokracia në Veprim (DnV) dhe Federata e Sindikatave e Shëndetësisë e Kosovës (FSShK) kanë kritikuar partitë politike për mosrespektim të masave kundër Covidit gjatë fushatës zgjedhore. Këto institucione kanë vlerësuar se tubimet e partive politike po rrezikojnë shëndetin e popullatës në përgjithësi dhe punëtorëve shëndetësorë në veçanti. Sipas tyre, mosreagimi i institucioneve që kanë për obligim t'i zbatojnë këto masa, është standard i dyfishtë që cenon barazinë e qytetarëve para ligjit

EPOKA
ERE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 9 SHKURT - Mosrespektimi i masave kundër Covidit nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore ka nxitur reagimin e shumë institucioneve dhe shoqërisë civile.

Tubimet e mëdha të subjekteve politike janë parë të rrezikshme për shëndetin publik nga Avokati i Popullit, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Demokracia në Veprim (DnV) dhe Federata e Sindikatave e Shëndetësisë së Kosovës (FSShK).

Avokati i Popullit është shprehur i shqetësuar me zbatimin

selektiv të masave të qeverisë për parandalimin e pandemisë Covid-19 gjatë fushatës zgjedhore. "Avokati i Popullit ka vërejtur se që nga fillimi i fushatës parazgjedhore nuk janë respektuar masat kundër Covidit nga ana e partive politike, në anën tjetër institucionet që kanë për obligim t'i zbatojnë këto masa nuk kanë reaguar. Ky është një standard i dyfishtë që nuk mund të tolerohet dhe cenon barazinë e qytetarëve para ligjit. Përveç kësaj, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij për rrezikimin e jetëve të qytetarëve për shkak të mosrespektimit të masave" është thënë në një deklaratë përmes një komunikate përmes media, KMDLNj ka vlerësuar se fushatat e partive politike përmes zgjedhjet e

merren me shkelësit e këtyre masave. "Avokati i Popullit edhe një herë rithekson obligimin që kanë të gjitha institucionet dhe partitë politike që t'i respektojnë masat për parandalimin e pandemisë, ndërsa fton autoritetet kompetente që të ndërmarrin veprime konkrete për respektimin e këtyre masave nga subjektit politike", është thënë në deklaratën e Avokatit të Popullit. Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kritikuar partitë politike për mosrespektim të masave kundër Covidit gjatë fushatës zgjedhore. Përmes një komunikate përmes media, KMDLNj ka vlerësuar se fushatat e partive politike përmes zgjedhjet e

14 shkurtit kanë eskaluar dhe po paraqesin rrezik për shëndetin publik. "Deri më tanë ishin pikërisht politikanët që bënin thirrje publike për respektim të masave që i ka paraparë Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, mbajtja e distancës sociale, vendosja e maskave mbrojtëse, përdorimi i mjeteve dezinfektuese sikur edhe ndalimi i grumbullimit të individëve, sidomos në objekte të mbyllura. Nga këto masa kanë pësuar qytetarët që janë gjobitur nga policia, edhe në raste banale sikur që janë dëmtuar shumë gastronomët", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, zbatimi i standardeve të dyfishta në këtë drejtim është diskriminues për qytetarët. "Nëse Policia e Kosovës, bashkë me Inspeksionin, përmes shkak të mosrespektimit të masave, përveç gjabave, si masë e shqiptojnë edhe mbylljen e lokaleve duke i larguar mysafirët, pse atëherë këtë standard të mbështetur në Ligjin përmes Pandeminës nuk e zbatojnë edhe ndaj tubimeve politike ku shkelen të gjitha

rregullat e mundshme? Pse duhet të jetë një standard për politikanët dhe mbështetësit e tyre dhe tjetër standard për bizneset dhe qytetarët e tjera?! Vendosja dhe zbatimi i standardeve të dyfishta përmes KMDLNj-së paraqet një standard diskriminues dhe shkelje të të drejtave të njeriut për trajtim të njëjtë para dhe sipas ligjit", ka vlerësuar KMDLNj-ja.

E shqetësuar me këto veprime të partive politike është shprehur edhe Federata e Sindikatave e Shëndetësisë e Kosovës (FSShK). Sipas kësaj sindikate, në këtë mënyrë po rrezikohet në masë të madhe shëndeti i popullatës në përgjithësi dhe punëtorëve shëndetësorë në veçanti. "Në situatë me pandeminë Covid-19 patriotizëm, atdherashuri dhe përkushtim përmes vendin tregojnë të gjithë ata që respektojnë masat, vendosin maskat, respektojnë distancën sociale e këtë gjë nuk po e shohim te partitë politike pa përfjashtim. Andaj, FSShK-ja e shqetësuar tej mase me sjelljet e figurave politike sikurse nuk ekziston virusi, sikurse jemi në situatë normale, paralajmëron të gjitha partitë politike që përgjegjësia në rast të rritjes së numrit të infektuarve me Covid-19 bie mbi ta dhe përmes këtë do t'i ndërmarrim të gjitha veprimet ligjore deri në parashtrim të padisë përmes rrezikim të shëndetit të përgjithshëm të popullatës, në veçanti të punëtorëve shëndetësorë", ka bërë me dije FSShK-ja. Ndërsa koalicioni i organizatave vendore përmes Vëzhgimin e zgjedhjeve Demokracia në Veprim (DnV) ka kërkuar nga inspektorët komunalë të reagojnë ndaj këtyre tubimeve. "Shqetësues mbetet fakti që subjektit politike vazhdojnë të mos respektojnë masat kundër Covidit, duke tejkaluar numrat e lejueshëm të grumbullimit të qytetarëve në tubime publike, duke mos respektuar rregullat përmes distancës sociale dhe mbajtjen e maskave në mënyrë të duhuar. Inspektoratet komunale, në anën tjetër, nuk janë duke u angazhuar përmes ta siguruar zbatimin e plotë të këtyre masave apo edhe shqiptimin e dënimive meritore përmes mosrespektimit e tyre", ka vlerësuar DnV-ja.



Qeveria do të ndajë 578 mijë euro përi riparim të protezave përi invalidët e UÇK-së


PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Invalidëve të

Luftës së UÇK-së, të prirë nga Fadil Shurdhaj, nga të cilët u njoftua për nevojën urgjente të mbështetjes financiare përi riparimin dhe furnizimin me

proteza. Kryeministri Hoti u pajtua që për nevoja emergjente, kësaj shoqate t'i ndahen mjete në vlerë prej 578 mijë e 345 eurosh, sipas

praktikave të mëhershme. Në takim ishte i pranishëm edhe drejtori i Zyrës përi Çështjen e Kategorive të Dala nga Lufta, Sylë Vitia.





INTERVISTË ME HISTORIANIN E NJOHUR FRANCEZ SERGE MÉTAIS

Kuvendi i Kosovës me ligj mund ta zhbëjë Gjykatën Speciale

Historiani i njojur francez Serge Métais, në një intervistë botuar në "Mediapart" në Francë, ka thënë se Gjykata Speciale nuk është krijuar nëpërmjet ndonjë rezolute të Kombeve të Bashkuara. Sipas tij, ajo nuk është ngritur as nëpërmjet ndonjë traktati mes shteteve. "Ajo është një institucion i Republikës së Kosovës. Është krijuar me një ligj të votuar nga Kuvendi i Kosovës. Gjithçka që është e bërë me ligj, mund të zhbëhet me ligj. Nuk ka asnje mekanizëm institucional mbishtetëror që të mund ta pengojë shkrirjen e Gjykatës së Posaçme dhe transferimin e dosjes së akuzës te gjykatat e Kosovës në Prishtinë. Dhe kjo, që nga momenti në të cilin Kuvendi i Kosovës do të votonte një ligj në këtë drejtim", ka thënë Métais

PRISHTINË, 9 SHKURT -
Për çfarë e keni saktësisht fjalën kur flisni për "mekanizëm gjyqësor" i cili mund të shndërrohet në "mekanizëm djallëzor"?

Serge Métais: Mekanizëm djallëzor unë quaj një gjykatë të posaçme që mund të katandiset të veprojë me gjaknxehtësi, me teprime, me pushtet të pakufizuar, me humbje të sensit

të masës. I tillë do të ishte, për t'i thënë gjërat më shkoqur, një dënim me burgim të përjetshëm për të akuzuarit. E gjitha kjo është e mundshme, në bazë të një aktakuze që konsideron se ata kanë ngritur e drejtuar një "sipërmarrje të përbashkët kriminale" (UÇK-në?), fajtore për krimet lufte dhe krimet kundër njerëzimit. Mospranimi për t'u dhënë të akuzuarve

lirimin me kusht më duket se nuk ndjell asgjë të mirë.

Pse doni që të mbyllët Gjykata e Posaçme?

Serge Métais: Më duket se e kam parashtruar qartë qëndrimin tim në artikullin që kam shkruar. Ka dy arsyet thelbësore: Së pari, mungesa e pretendimeve për trafik organesh, në aktakuzë, bën që Gjykata e Posaçme ta


ketë humbur tashmë çdolloj legjimit. Së dyti, një proces në Hagë i jep faktikisht kësaj gjykate të posaçme një status të cilin ajo nuk ka sesi ta mëtojë, statusin e një gjykate penale ndërkombëtare. Mirëpo është e paimagjinueshme që, në një gjykatë penale ndërkombëtare, të gjykohet vetëm njëra nga palët në konflikt. Në qoftë se gjykohet vetëm pala shqiptare, pa u gjykuar pala serbe, do të kishte një prishje të barazisë së trajtimit ndërmjet palëve. Kjo do të ishte një padrejtësi e kulluar.

Personeli i Gjykatës së Posaçme (gjyqtarë e prokurorë) është ndërkombëtar. Ndërkohë, ju keni mendimin që mbyllja e kësaj gjykate mund të vendoset nga Kuvendi i Kosovës. A e ka ky vërtet këtë kompetencë?

Serge Métais: Gjykata e Posaçme nuk është krijuar përmes ndonjë rezolute të Kombeve të Bashkuara. Ajo nuk është ngritur as nëpërmjet ndonjë traktati mes shtetesh. Ajo është një institucion i Republikës së Kosovës. Është krijuar me një ligj të votuar nga Kuvendi i Kosovës. Gjithçka që është e bërë me ligj, mund të zhbëhet me ligj. Nuk ka asnje mekanizëm institucional mbishtetëror që të mund ta pengojë shkrirjen e Gjykatës së Posaçme dhe transferimin e dosjes së akuzës te gjykatat e Kosovës në Prishtinë. Dhe kjo, që nga momenti në të cilin Kuvendi i Kosovës do të votonte një ligi në këtë drejtim.

A nuk keni frikë se kjo gjë mund të shkaktojë një krizë midis Kosovës dhe aleatëve të saj, evropianë dhe amerikanë?

Serge Métais: Sigurisht, kriza do të ishte serioze. Idealja do të kishte qenë që nisma të vijë nga




projektligji për shkrirjen e Gjykatës së Posacme dhe transferimin e dosjes së akuzës në Kosovë. - Vetëm në një fazë të dytë, Kuvendi mund ta votojë pastaj ligjin që do ta zhbënte atë që është bërë me ligjin e vitit 2015. Ndërkohë, kriza do të ishte hapur me aleatët. Ajo do të jepte rastin për një debat rreth mashtimit të madh pjellë e të cilit është Gjykata e Posacme, rastin për të rikujtuar kushtet tejet të veçanta në të cilat u ngrit kjo gjykatë, e kështu me radhë. Kuptohet vetveti që kriza e celur përmes votimit të rezolutës duhet të çojë në negociata me aleatët. Projektligji që do të votohej më pas mund të shfaqet atëherë si fryt i një marrëveshjeje.

A mendoni ju që do të mund të gjykojen ndonjëherë në Hagë krimet e kryera nga serbët në Kosovë?

Serge Métais: Jo. Krimet e kryera nga ushtria, forcat e sigurisë dhe paraushtarakët serbë gjatë luftës së viteve 1998-1999 nuk mund të gjykojen nga Gjykata Penale Ndërkombëtare, sepse kjo është krijuar vetëm në vitin 2002 dhe kompetencat e saj nuk janë prapavepruese. Madje, gjykimi i këtyre krimeve nuk është as në kompetencën e Gjykatës së Posacme për Kosovën. Krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimi i gjenocidit të kryera nga serbët në Kosovë nuk do të gjykojen pra kurrë në Hagë. Nëse ato do të gjykojen ndonjëherë, kjo mund të ndodhë vetëm në suazën e gjykatave të Serbisë ose të Kosovës. Pikërisht edhe për këtë arsy, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit për të cilat akuzohen sot udhëheqësit e UÇK-së do të duhej të gjykojen në Prishtinë. Për sa kohë që ndaj tyre nuk është ngritur kurrrafëakuze lidhur me trafik organesh, nuk mund të ketë asnjë justifikim që procesi i tyre të jetë i zhvendosur në Hagë.

vetë amerikanët ose evropianët të cilët ranë në kurthin e mashtimit të madh të raportit Marty. Por nuk duhet të kemi iluzione: ka fare pak gjasa që ata ta ndërmarrin vetë hapin e parë. Kuvendi i Kosovës mund të veprojë në dy fazë: - Si fillim, ai mund të votojë thjesht një rezolutë ku të merret në konsideratë mungesa e pretendimeve për trafik organesh në dosjen e akuzës. Dhe mjafton që kjo rezolutë të vendosë ngritjen e një komisioni të ngarkuar me hartimin e një

(Intervista është përkthyer në gjuhën shqipe nga Arben Leskaj)



Lajçaku nuk pret marrëveshje të shpejtë në mes të Kosovës dhe Serbisë

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka thënë se nuk pret ndonjë marrëveshje të shpejtë për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 9 SHKURT - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, u ka thënë përfaqësuesve të vendeve anëtare të bllokut, se nuk pret ndonjë marrëveshje të shpejtë për normalizimin e raporteve në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Ai, po ashtu, u ka thënë shteteve anëtare se nuk do të organizojë ndonjë raund të ri të bisedimeve, derisa në Kosovë të mos formohen institucionet e reja që pritet të dalin pas zgjedhjeve të 14 shkurtit.

Lajçaku ka folur para ambasadorëve në Komitetin për Politikë dhe Siguri, ku ka prezantuar punën e tij të deritashme, kur po afrohet fundi i mandatit të tij njëveçar. Ky mandat skadon në fund të muajt të ardhshëm dhe sipas burimeve diplomatike, ai pret që Këshilli i BE-së t'ia vazhdojë mandatin. Sipas burimeve, që janë në dijeni të diskutimeve në komitetin përkatës, Lajçak ka thënë se nuk mund të flasë më për afatet kohore se kur mund të pritet ndonjë marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këtë ai e ka arsyetuar me situatën politike në Kosovë dhe nevojën që të pritet formimi i institucioneve të reja. Lajçak, sipas këtyre burimeve, ka thënë se duhet pritur që edhe Prishtina e Beogradit t'u tregojnë qytetarëve të vet se çfarë kompromisesh janë të nevojshëm për një marrëveshje eventuale, raportori "REL".

Paraqitura e Lajçakut para përfaqësuesve të 27 vendave anëtare duket krejt e ndryshme nga ajo që ai thoshte në vit më parë, në fillim të mandatit. Në atë kohë ai thoshte se nuk ka kohë për të humbur dhe se do të punojë për arritjen e një marrëveshjeje sa më shpejt që të jetë e mundur.

"Është çështje muajsh e jo vitesh", thoshin atëbotë nga Bashkimi Evropian.

Lajçaku ka folur edhe për nevojën e bashkëpunimit në mes të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ka konfirmuar se pret mbështetje për punën e tij nga administrata e re amerikane e presidentit Joe Biden.

Në këtë diskutim thuhet se



shumë përfaqësues të vendeve anëtare të bllokut evropian e kanë konsideruar si lehtësim të madh faktin se tash do të ketë një mbështetje amerikane për dialog. Madje disa burime thonë se Lajçak ka përmendur edhe termin "sabotim", duke thënë se "tash nuk pret më sabotime nga Washingtoni", duke iu referuar aktivitetave të ish-ambasadorit Richard Grenell, i cili ishte emëruar i dërguar i posaçëm i ish-presidentit Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi.

Kështu viti i parë i mandatit të Miroslav Lajçakut dhe ekipit të tij ka mjaftuar vetëm për ta quajtur si sukses të madh faktin se dialogu ka rifilluar. Që nga muajsi shtator i vitit 2020 nuk ka pasur më takime të nivelit të lartë në kuadër të dialogut. Edhe pasi ai kishte rifilluar në korrikun e kaluar, palët kanë pasur qëndrime të kundërtë për shumë pika, sidomos rreth krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Kosova ka refuzuar që të bisedohej për këtë temë, ndërkohë Serbia ka insistuar që asociacioni të formohet pasi ka argumentuar se ky është obligim që del nga Marrëveshja e Brukselit.

Bashkimi Evropian vazhdimisht i ka bërë thirrje Kosovës që ta zbatojë marrëveshjen për asociacionin, duke rikujtuar se Kosova "ka marrë obligim për këtë edhe përmes miratimit të saj në Kuvendin e Kosovës". I dërguari i posaçëm i BE-së, Miroslav Lajçak, ka thënë në këtë

takim, sipas burimeve diplomatike evropiane, se ai nuk do të rifillojë nga zeroja, por do të vazhdojë aty ku kanë mbetur me dialogun dhe kjo do të ndodhë pasi të krijohen institucionet e reja në Kosovë.

Sa i përket bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në BE i gjëzohen këtij bashkëpunimi, por nuk janë në gjendje të thonë nëse edhe BE-ja e ndan qëndrimin se qëllimi i dialogut duhet të jetë njohja e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë, ashtu siç ka kërkuar presidenti amerikan Joe Biden në një letër dërguar presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç.

E pyetur se çfarë marrëveshje pret që të arrihet në mes të Kosovës dhe Serbisë, BE-ja thotë se "pret marrëveshje për normalizim gjithëpërfshirës të raporteve, ligjërisht obliguese, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, standardevropiane dhe të pranueshme për të gjitha vendet e Bashkimit Evropian".

Nën ndërmjetësimin e BE-së, dialogu midis Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Pas një pauze 20-mujore, dialogu rinisi në korrikun e vitit 2020.

Takimi i fundit i udhëheqësve të Kosovës dhe Serbisë u zhvillua në shtatorin e vitit të kaluar. Deri në zgjedhjen e Qeverisë së re të Kosovës, Brukseli zyrtar ka paralajmëruar se nuk do të ketë takime në kuadër të dialogut.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbahen më 14 shkurt.

Edhe 234 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 9 SHKURT - Në Kosovë u raportuan të martën 234 raste të reja me Covid-19 dhe dy viktima. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë

Publike, viktimat u regjistruan në Prishtinë dhe në Prizren. Rastet e reja, ndërkaq, rezultuan pas testimit të 2 405 mostra. Në Kosovë

aktualisht janë 6 814 raste aktive me Covid. Në total numri i të infektuarve ka arritur në 62 782. Prej tyre 1 528 patientë kanë vdekur dhe 54 440

janë shëruar. Vetëm në 24 orët e fundit janë shëruar 209 patientë, bëjnë me dije të dhënë Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.



Ambasadori Minxhozi premton përkrahje për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, gjatë takimit me kryeshefin ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Bedri Zyberaj, është zotuar se do ta ofrojë përkrahjen maksimale për këtë institucion

PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore i Arkivave i Kosovës, Bedri Zyberaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi.

Zyberaj e ka njoftuar Minxhozin për kushtet dhe për gjendjen aktuale të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, duke e informuar rrëth thesarit dokumentar që ruan AShAK si dhe rrëth mungesës së kushteve infrastrukturore dhe problemeve me të cilat ballafaqohet ky institucion.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua mungesës së objekteve dhe kushteve për arkivat

ndërkunale të cilat veprojnë në kuadër të AShAK-së. Zyberaj ka paraqitur edhe aktivitetet e realizuara falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me arkivat e rajonit, duke veçuar bashkëpunimin me Drejtoren e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, i cili nuk është vetëm bashkëpunim profesional, por edhe vëllazëror, me ç'rast njoftoi për aktivitetet e përbashkëta të realizuara në mes të këtyre dy institacioneve, si për hapjen e Këndit Arkivor të DPA-së në Sallën e Leximit të AShAK-së, hapjen e ekspositave të përbashkëta dhe organizimin e



Konferencës së përbashkët Mbarëkombëtare të Arkivistikës etj.

Ambasadori Minxhozi ka shprehur falënderim për pritjen e tij ku, ndër të tjera, ka theksuar se ishte nder dhe kënaqësi për të vizituar një

institucion të rëndësishë së veçantë siç është AShAK dhe shprehu gatishmërinë për një bashkëpunim më intensiv në të ardhmen. Ambasadori Minxhozi u zotua se do ta ofrojë përkrahjen maksimale për AShAK-në duke

u angazhuar dhe në cilësinë e dekanit të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Kosovës detyrë shtesë që ka tani. Minxhozi ka shprehur bindjen e plotë se një angazhim i tillë do të ketë rezultate të prekshme në të ardhmen e afërt.

9 382 foshnja u mjekuan në Klinikën e Neonatologjisë



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 SHKURT - Në Klinikën e Neonatologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, gjatë vitit 2020 kanë marrë shërbime mjekësore 9 382 foshnja. Prej tyre, 8 905 foshnja janë referuar nga Klinika e Gjinekologjisë, kurse 477 të tjera nga spitalet rajonale, spitalet private apo nga shtëpia, për shkak të manifestimeve klinike.

Në Kujdesin Intensiv dhe Gjysmë Intensiv të Klinikës së Neonatologjisë janë trajtuar 1 256 foshnja, nga to 512 iu kanë nënshtuar ventilimit mekanik

(ventilatorit), ndërsa 512 foshnja të tjera janë vendosur në CPAP Nazal (presion pozitiv me oksigjen).

Te 160 foshnja të lindura para kohe është aplikuar survanta (substancë që nuk prodhohet në mushkëritë e foshnjave të lindura para kohe).

Në hapësirën e destinuar për trajtimin e rasteve të dyshuara apo të konfirmuara me Covid-19 janë pranuar 60 foshnja të lindura, prej tyre vetëm katër kanë rezultuar pozitiv. Në bazë të raportit vjetor janë kryer 3 646 vizita ambulantore, derisa janë realizuar 915 echokardiografi, 858 echo të abdomenit dhe 787 echo të sistemit nervor qendror.

Fillon procesi i akreditimit të programeve në UShAF

FERIZAJ, 9 SHKURT (ER) - Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka filluar procesi i vlerësimit për akreditim dhe riakreditim të programeve. Në proces të akreditimit këtë

vit janë gjashtë programe nga të cilat dy programe janë të reja dhe katër përiakreditim. UShAF-i është themeluar në vitin 2015 dhe nga atëherë ka rritur numrin e programeve.

Vitin e kaluar UShAF ka përmbyllur me sukses akreditimin institucional dhe që nga muaji tetor i këtij viti pritet të ofrojë njëmbëdhjetë programe mësimore atraktive të cilat

janë të përshtatura me kërkesat e tregut. Edhe këtë vit UShAF-i ka bërë përgatitjet e duhura për procesin e akreditimit për të cilat beson se do të përfundojnë me sukses.



Aktivitetet e partive politike në kuadër të fushatës së zgjedhjeve të 14 shkurtit

Hoxhaj: Rimëkëmbja e sektorit të prodhimit, prioritet i qeverisë sime

PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka vizuar fabrikën e barnave "Tropharm". Hoxhaj ka thënë se rimëkëmbja e sektorit të prodhimit është prioritet i qeverisë së tij. "Bizneset inovative si 'Tropharm' do të mbështeten me grante investive dhe pako të ndryshme stimuluese. Mbi 500 milionë euro të planifikuara në programin tonë do të shkojnë si mbështetje direkte për bizneset dhe prodhuesit vendorë. Do të bëhet edhe ulja e tatimit në të ardhura të korporatave nga 10 për qind, në 8 për qind, 7 për qind, 5 për qind dhe 0 për qind, varësisht nga investimet dhe numri i të punësuarve. Por, po ashtu, do ta rrisim edhe kapitalin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive deri në 100 për qind. Gjatë qeverisjes sime çdo kontest biznesor do të zgjidhet shpejt

zgjedhor në Malishevë, se kundërshtarët e LDK-së në këtë proces zgjedhor janë njerëzit që i kanë kundërshtuar vazhdimisht proceset e rëndësishme që ka kaluar Kosova në 30 vjetët e fundit. "Këta që i kemi në garë nuk janë të sotëm. I kemi pasur pengesë në rrugën e shtetndërtimit qe 30 vjet. Kanë qenë pakicë që na kanë bërë pengesa në procesin e shtetndërtimit. Disa që këta të majtit i kanë idol, bënin thirrje për të dalë në zgjedhjet e Serbisë. Janë vrarë njerëz për ta kundërshtuar planin e Ahtisarit. Njëjtë na e kanë bërë edhe përmarrëveshjen e Uashingtonit, veç s'kanë pasur guxim të na sjellin dhunë siç bënë për çështjen e kauzës së rreme të demarkacionit. Marrëveshja e Uashingtonit e fuqizon shtetësinë e Kosovës në arenën ndërkombëtare", ka thënë Hoti. Ai u shpreh i bindur se qytetarët e Kosovës do ta vlerësojnë punën



dhe "Cenbaza" janë vetëm një pjesë e mozaikut të prodhuesve të Rahovecit të cilët na bëjnë krenarë të gjithë neve. "Deri 80 për qind të prodhimeve të tyre eksportohen jashtë vendit, tregues ky i cilësisë së lartë që ka prodhimi vendor", ka thënë Haradinaj gjatë vizitës së tij në komunë.

Ai ka thënë se dora e shtetit do të ndihet te të gjithë prodhuesit e ndërmarrësit që u goditën nga kriza ekonomike e shkaktuar si pasojë e pandemisë. "Programi i Aleancës ka paraparë deri në hollësi përkrahjen për ta, ndërprerjen e rënies dhe stimulimin e rritjes ekonomike në vend", ka dekluaruar Haradinaj.

Lideri i AAK-së ka vizuar edhe Komunën e Suharekës, ku ka vizuar fabrikën e mobilieve "Te Naseri". "Kosova ka potencial të madh zhvillimi dhe garanci përkëtë janë bizneset vendore, punën e të cilëve po e shoh nga afër. I impresionuar me përkushtimin dhe vullnetin e tyre për punë, veçanërisht grave ndërmarrëse të cilat çdo ditë e më tepër po bëhen shembuj suksesi", është shprehur Haradinaj.

Limaj: Kauza 'Me Çlirimtarët' po merr përkrahje të madhe

MALISHEVË, 9 SHKURT (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate,

të kësaj zone, që tashmë kanë vendosur që më 14 shkurt ta votojnë numrin 121 të Nismës Socialdemokrate, për të pasur një zë të fuqishëm të çlirimtarëve në Kuvend dhe kudo në institucionet tona", ka thënë Limaj.

Kurti: Nuk do të bëjmë koalicionë paszgjedhore

Shtime, 9 shkurt - Kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti dhe kandidatja për presidentë në listën e kësaj partie, Vjosa Osmani, kanë vizuar të martën qytetin e Shtimes, në kuadër të fushatës përzgjedhjet e 14 shkurtit. Kurti ka thënë se me Osmanin janë bërë bashkë për të formuar një shumicë parlamentare. "Me presidenten Vjosa Osmani jemi bërë bashkë, e



dhe pa burokraci, sepse ne do ta themelojmë edhe Gjykatën Komerciale", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Hoti: Oponentët e LDK-së penguan proceset më të rëndësishme të Kosovës për 30 vjet

Malishevë, 9 shkurt (ER) - Kandidati i LDK-së për kryeministër, Avdullah Hoti, ka thënë të martën, në tubimin



të votojnë për numrin 121, përnjë zë të fuqishëm të çlirimtarëve në Kuvendin e Kosovës", ka shkruar Limaj në rrjetet sociale.

Ai ka theksuar se rreshtimi me plot dinjitet dhe krenari i përkrahësve të shumtë në të gjitha komunat krah kauzës "Me Çlirimtarët" është garanci që deputetët e Nismës do ta mbrojnë e ta promovojnë sakrificën e lavdishme të popullit. "Kauza jonë ka bashkuar njerëz të mirë, familje patriotike dhe të rinj

kemi realizuar koalicionin parazgjedhor. Andaj zgjedhjet e reja janë një referendum gjithëpopullor me ç'rast ne synojmë një fitore të madhe që ta bëjmë shumicën popullore, shumicë parlamentare. Nuk do të bëjmë koalicionë paszgjedhore sepse i kemi bërë ato parazgjedhore. Nuk do të qeverisim për t'ju sunduar dhe nuk do të qeverisim për t'u pasuruar. Do të vazhdojmë të jemi klasë e mesme", ka thënë Kurti.



Fillon shpërndarja e 20 milionë eurove për 19 000 fermerë



PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka njoftuar se ka nisur shpërndarja e 20


milionë eurove për 19 mijë fermerët. Sipas Hotit, deri në fund të javës do të kryhen plotësisht këto pagesa. "Në

Programin për Rimëkëmbje Ekonomike kemi dyfishuar subvencionet në bujqësi. Ministria e Financave ka

filluar disbursimin e 20 milionëve për 19 000 fermerë. Deri në fund të javës do të kryhen

plotësisht. Ju premtojmë se do ta vazhdojmë mbështetjen", ka njoftuar Hoti.

ATK-ja: Gjatë muajit janar janë shqiptuar 130 gjoba te bizneset



PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se gjatë muajit janar 2021 janë shqiptuar 130 gjoba nga vizitat te bizneset. Sipas ATK-së, gjatë këtij muaji janë bërë mbi 3 000 vizita. "Deri më datë 31 janar janë kryer 3 355

vizita te bizneset, ku si rezultat i tyre janë lëshuar 130 gjoba përgjimet e konstatuara nga inspektoret tatimor në terren. Po ashtu, nga vizitat e realizuara është konstatuar mall pa originë, si dhe mungesë në stoqe në vlerë 1.1 milion euro",

thuhet në njoftimin e ATK-së. Përveç vizitave, ATK-ja tregon se inspektorët tatimore kanë përfunduar 78 kontroll te bizneset të cilat janë identifikuar nga moduli i analizës së riskut. "Tatimi shthesë nga këto kontolle të kryera është 1.6 milion euro,

ndërsa kreditimi i zbritur është gjysmë milion euro, kurse humbja e zbritur e konstatuar me kontroll është 1.6 milion euro. ATK-ja do ta vazhdojë zbatimin e planeve operative, me qëllim të identifikimit të të gjitha rasteve të shprehjeve

tatimore, andaj u bëjmë thirrje të gjithë tatimpaguesve që t'i përmblushin obligimet e tyre tatimore, në mënyrë që mos të jenë objekt i ndëshkimeve të parapara me legjisacionin tatimor në fuqi", është theksuar në njoftimin e këtij institucionit.

Afër dy milionë euro pasuri e sekuestruar



PRISHTINË, 9 SHKURT - Rreth 1.6

million euro është vlera e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara në vitin 2020 dhe të cilat janë në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar. Vlera totale e pasurisë së administruar nga kjo agjenci, që nga themelimi i saj një dekadë më parë, është afersisht 40 millionë euro. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe bashkëpunon me organet e drejtësisë, në mënyrë që ta luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin në Kosovë.

Konfiskimi nënkuption marrjen e përhershme të pasurisë sipas urdhrit të formës së prerë nga gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent në pajtim me ligjin në fuqi, kurse sekuestrimi nënkuption marrjen e pasurisë nga organi kompetent deri në vendimin e prerë të gjykatës. Ardian Bajraktari, ushtrues i detyrës i sekretarit të

përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, tha për "Radion Evropa e Lirë" se, veç aseteve që janë në depon e agjencisë, ka edhe shtëpi e banesa të cilat janë të sekuestruara edhe konfiskuara, e që janë nën mbikëqyrjen e agjencisë, por edhe një sasi e arit e cila ruhet nga Banka Qendrore.

Çfarë ndodh me pasurinë e konfiskuar?

Agjencia, po ashtu, bën vlerësimin e pasurisë së konfiskuar dhe sekuestruar dhe pas një vendimi të prerë nga gjykata, mundëson shitjen e saj. "Ankandet dalin për pasuritë të cilat janë të konfiskuara me vendim të plotfuqishëm të gjykatës. Ndërsa, kur pasuria është e ngrirë ose e sekuestruar, ato vetëm administrohen nga ana e agjencisë", ka thënë Bajraktari.

Shumë nga informacionet të cilat dërgohen në prokurori si raste të dyshuar për pasuri të

fituar në mënyrë jo të ligjshme, janë nga Agjencia Kundër Korrupsionit, e cila është agjenci e pavavarur.

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havollli, tha për "Radion Evropa e Lirë", se gjatë trajtimit të rasteve nga deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë, agjencia ka hasur në parregullsi të ndryshme të deklarimit të pasurisë. Ai tregoi se në bazë të deklaratave ka pasur mospërputhje mes asaj që kanë deklaruar zyrtarët dhe gjetje gjatë trajtimit të rasteve. "Prokuroria ka zhvilluar hetime lidhur me këtë çështje dhe ka informacione se përkohësisht ka sekuestruar pasuri të caktuar", ka deklaruar Havollli.

Vonesa në gjykata

Megjithatë, Havollli konsideron se sistemi i drejtësisë është duke u vonuar, duke i komplikuar punët dhe duke keqmenaxhuar pasurinë e konfiskuar dhe të sekuestruar. "Gjykatat duhet të janë më azhure që të sjellin

vendime, qoftë të sekuestrojnë, qoftë të konfiskojnë apo të sjellin vendime që ato asete të shiten apo edhe të ruhen paratë nga shitja e tyre në xhirologjitetë shtetërore. Duhet të ndryshohet qasja e menaxhimit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar sepse nga kjo çështje shtetit po i krijuhet barrë për ruajtjen dhe po i krijon shpenzim në vend se të ishte e kundërt", ka thënë Havollli.

Në anën tjetër, Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), thotë se ka tendencat nga disa institucione për ta paraqitur punën efektive me shifra madhore të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituan në mënyrë të kundërligjshme. Ai thotë se shpesh haset në shifra të ndryshme të konfiskimit të pasurisë ndër vite. "Ende ka shumë pak aktgjykime dënuese lidhur me këto vepra penale e shumë më pak kërkesa për konfiskim të pasurisë. Si rrjedhojë kemi një situatë kur jo

vetëm Ministria e Drejtësisë, por pothuajse të gjitha institucionet në një farë mënyre manipulojnë me statistika e të dhëna, duke dërguar mesazhe të rrejshme lidhur me sekuestrimin apo konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale", ka thënë Miftaraj. Sipas tij, konfiskimi i pasurisë nuk mund të ndodhë nëse nuk do të ketë dëname të plotfuqishme dënuese nga ana e gjykatave.

"Radio Evropa e Lirë" ka kërkuar edhe një përgjigje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për të shpjeguar lidhur me vonesat e vendimeve për çështjen në fjalë, por deri tash nga ky institucion nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje.

Në Ministrinë e Drejtësisë thonë se në periudhën kohore qershor-dhjetor 2020 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ka ekzekutuar gjithsej 92 vendime të dërguara nga gjykatat për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Restorantet në Nju-Jork do të fillojnë të punojnë me kapacitet të kufizuar

NJU-JORK, 9 SHKURT - Hapësirat e brendshme të restoranteve në Nju-Jork, që u mbyllën si pjesë e luftës kundër përhapjes së pandemisë Covid-19, do të fillojnë të funksionojnë me kapacitet 25 për qind.

Sic njofton guvernatori Andrew Cuomo, hapja do të fillojë nga 12 shkurti. Ndërsa paralajmërimi për rihapje më herët ishte bërë duke bërë me dije se do të ndodhë më 14 shkurt, në Ditën e të

Dashuruarve. Ai ka shtuar se është regjistruar një rënie e ndjeshme e numrit të infeksioneve dhe vdekjeve të reja nga Covid-19 në shtetin amerikan. Pjesët e brendshme

restoranteve u mbyllën më 11 dhjetor të vitit të kaluar. Sipas Worldometer, më shumë se 1.5 milion qytetarë të Nju-Jorkut ishin infektuar Covid-19, ndërsa rreth 45 mijë prej tyre vdiqën.



Kryetari Kastrati nënshkruan memorandum bashkëpunimi me PREDA Plus Kosovë

KAMENICË, 9 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Valentin Hoxha, autoritet zbatues në kuadër të Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshmëm Ekonomik - PREDA Plus Kosovë dhe WEntrepreneur. Projekti: "Stabilizimi i mëtejmë i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë përmes mbështetjes së shtuar socio-ekonomike", i njojohur gjithashtu si "Socio - Projekti 2", e që ka për qëllim bashkëpunimin në disa fusha si mbështetja e bizneseve ekzistuese, fuqizimi i mëtejmë i organizatave të mbështetjes së

biznesit, mbështetja e themelimit të bizneseve fillestare, themelimi dhe mbështetja e ndërmarrjeve sociale dhe mbështetja e iniciativave për zhvillim të komunitetit.

Ndryshe, Socio-Projekti 2 lanson Skemën e Granteve "Gratë në biznes dhe sipërmarrësit e rindj", në të cilën mund të aplikojnë gratë 18-65 vjeç dhe të rinjtë 18-35 vjeç, të cilët janë të interesuar për t'i krijuar bizneset e tyre të reja në Komunën e Kamenicës. Në fazën e parë projekti do të pranojë vetëm pyetësorë të plotësuar nga individë të interesuar, në të cilët do të përshkuhen idetë për biznes.



29 të shëruar nga Covid-i në Malishevë



MALISHEVË, 9 SHKURT (ER) - Në 24 orët e fundit në territorin e Komunës së Malishevës, 29 persona janë shëruar nga Covid-19, ndërsa janë shënuar gjashtë raste të reja. Këto të dhëna janë konfirmuar nga ana e IKShPK-së dhe IRShP-së në Prizren në komunikimin e

rregullt me Komunën e Malishevës, si dhe komunikim me raste në terren. "Rastet e reja me Covid: Tri raste në Ngucat dhe tri raste në Turjakë, ndërsa një rast tjetër është regjistruar gabimisht në listë, pasi nuk është nga Komuna e Malishevës", ka njoftuar

Komuna e Malishevës. Gjendja e përgjithshme me Covid-19 në Komunën e Malishevës është kjo: Nga data 14 mars 2020 e deri më sot me Covid-19 janë regjistruar 768 raste, prej tyre 667 janë shëruar, 45 kanë vdekur dhe aktiv me Covid-19 janë edhe 56 persona.

Në Han të Elezit diskutohen sfidat për riintegrin e të kthyerve

Hani i Elezit, 9 shkurt (ER) - Në Komunën e Hanit të Elezit është organizuar tryeza me temë "Sfidat mbi riintegrin e të kthyerve", ku pjesëmarrës ishin anëtarë të strukturave të sigurisë (KKSBB) nga Komuna e Hanit të Elezit dhe kryetari i kësaj komune, Rufki Suma. Suma ka prezantuar gjendjen e sigurisë në këtë komunë, me theks në angazhimin e komunës për parandalimin dhe riintegrin e personave të kthyerve.

Ndërkohë Ganimete Gërbovci, shefe e Divizionit për Siguri, Parandalim dhe Riintegrin në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka thënë se procesi i riintegrimit të personave të radikalizuar paraqet një proces kompleks, përmes së cilët MPB-ja synon që këta persona të mund të bashkohen sërisht me komunitetin dhe të jenë pjesë e dobishme e tij, përmes procesit të riintegrimit dhe rehabilitimit.



Komuna e Prizrenit i liron qytetarët e saj nga provizioni i PTK-së për pagesat komunale

PRIZREN, 9 SHKURT (ER) - Duke filluar nga data 1 mars 2021, qytetarët e Komunës së Prizrenit nuk e kanë për obligim ta paguajnë provisionin në vlerë prej 0.50 centësh për PTK-në, për të gjitha pagesat komunale që kapin shifrën deri në 9.99 euro. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori Drejtorisë së Administratës, Osman Hajdari, të martën kanë bërë prezantimin e këtij shërbimi të ri që do të jepet për herë të parë në Kosovë, në Qendrën e Shërbimeve të Integrugra (One-Stop-Shop). Me këtë rast, kryetari Haskuka ka deklaruar se në bazë të kërkesave të

shumta që kanë pranuar nga qytetarët, Komuna e Prizrenit ka vendosur që në Qendrën e Shërbimeve të Integrugra (One-Stop-Shop), të funksionalizohet edhe shërbimi postar duke hapur brenda saj sportelin e Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) dhe duke e eliminuar provisionin të cilën tashmë përsipër do ta ketë komuna. Nga ana tjetër, drejtori Hajdari ka theksuar se prej funksionalizimit të QShL-së, e cila është shembull jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon, nga xhepi i qytetarëve të Prizrenit kanë arritur t'i kursejnë mbi 120 mijë euro duke i thjeshtëzuar mbi 110 procedura të ndryshme.



Nëse LV-ja nuk e fiton shumicën absolute, nuk do ta bëjë as qeverinë!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Një hyrje pa dalje: Presioni që u është bërë qytetarëve të Kosovës nëpërmjet sondazheve nuk ishte asgjë tjetër përvëç një propagandë gebelsiane e që për qëllim kishte që perceptimin për disponim të qytetarëve ta përkthejë në përqindje të votave duke e bërë një dallim stratosferik midis LV-së, në njëri-anë dhe subjekteve të tjera politike në anën tjetër. Kurrë nuk kam qenë pjesë e matjes së opinionit përforsën politike të një subjekti politik apo koalicioni para zgjedhjeve, mirëpo gjithmonë kam parashikuar rezultatet me një saktësi prej 99-përqindësh. Pjesëmarrja masive në tubimet zgjedhore përmua nuk është fare tregues përfuqinë e një subjekti politik apo rezultatin e zgjedhjeve aq më parë që, përfundimisht e konsoliduara, që kanë shtrirje

dhe strukturë horizontale dhe vertikale dhe që kanë para të mjaftueshme, bartja e haxhilerëve partikulare, nga një vend në tjetrin, nuk është problem logistik, por një çështje thjesht teknike. Përmua është me rëndësi struktura e partisë, konservatorizmi i votuesve, trendi i kohës dhe basenet me vota. Ndërkombëtarët mund të luajnë rol në përcaktimin e votës përmes votues të luhatshëm dhe përata që janë mësuar të bëjnë "shtatë palë qefje", me sy kah dielli dhe me prapanicë kah ndërkombëtarët. Këto kritere i përdori edhe gjatë parashikimit që e bëjnë sot e që shumë pak ose fare hiç mund të ndryshojë deri në ditën e votimit. Parashikimet që i kam bërë para një muaji, përkundër bombardimeve drithëruese të sondazhistëve të ndryshëm, nuk i kam ndryshuar fare. Realisht mendoj se Instituti "Gani Bobi" ka një përvojë dhe kredibilitet sikur edhe Fisnik Halimi nga PIPOS. Rezultatet dallojnë shumë. Se edhe vetë LV-ja ka dyshime në rezultatet e sondazheve tregon fakti se Besnik Bislimi dhe Armend Muja nuk po dalin tash me sondazhe. Më parë Armend Muja, pasi u ankorua në LV, doli me një

sondazh të kripur sikur edhe Bisla që doli me një sondazh përmes Komunën e Gjilanit ku LV-ja kishte 29 përmes, LDK-ja 31 përmes dhe PDK-ja 18 përmes qind e të cilin e hoqi menjëherë nga faqja e LV-së. Po cilat do të jenë rezultatet:

1. LV-ja do të fitojë sepse trendi është në favor të saj. Fillimi i përmesgjante një ortekut që fshin çdo gjë para vetes, tash situata është më e qetë. Në zgjedhjet e 14 shkurtit LV-ja do të fitojë 37-38 përmes qind të votave.

2. LDK-ja nuk do t'i fitojë këto zgjedhje sepse trendi është kundër saj, por në asnjë mënyrë nuk mund të shembet si ia dëshirojnë disa. LDK-ja do të garoje përmes vend të dytë me PDK-në dhe mund të fitojë 23-25 përmes qind të votave.

3. PDK-ja ka qenë më e goditura, jo nga elektorati, por nga Gjykata Speciale Raciste. Vetëm struktura organizative e fortë e mban ende në lojë. Besoj se edhe PDK-ja do të fitojë 23-25 përmes qind të votave.

4. AAK-ja ka votues tradicionalë që e mbajnë në lojë përmes formimin e institucioneve, jo rrallëherë si përcaktues përmes formimin e tyre. Do të fitojnë 8-10 përmes qind të votave.

5. Lista Serbe do të rrisë shumë

pazarin përmes formimit të institucioneve. Përveç 10 deputetëve që i fiton, pa asnjë problem ka mundësi t'i fusë nën kontroll edhe 4 deputetë të pakicave joserbe, Adriana Hoxhiqin dhe Gazmend Salijeviqin.

6. Nisma Socialdemokrate është në situatë të luftojë përmes mbijetesë. Do ta ketë shumë të vështirë. Mendoj se mund të shkojë 4-5 përmes qind.

Koalicionet e mundshme pas zgjedhjeve: Nëse këto rezultate dalin të sakta apo përafërsisht të sakta, do të jetë problem të formohet një qeveri stabile, pa një koalicion të gjërë.

1. LV-ja bashkë me AAK-në dhe minoritetet do ta formonte një qeveri të pakicës dhe të paqëndrueshme që do të mbetej peng i kushtëzimeve të Listës Serbe. LV-ja, në koalicion me LDK-në, pakicat dhe AAK-në, do ta formonte një qeveri të qëndrueshme e cila, nëse i harmonizon qëndrimet dhe qëllimet politike, ekonomike dhe shtetërore, do të ishte në gjendje t'i shqyjë para të gjitha proceset, ligjet dhe ndryshimet e Kushtetutës. Edhe në dialog me Serbinë do ta kishte një

përfaqësim serioz dhe të respektueshëm. Ky kombinim do ta defaktorizonte Vjosa Osmanin skajshmërisht.

2. LV-ja, bashkë me PDK-në dhe pakicat, do të krijonte një qeveri stabile. Dyshoj se LV-ja do të bëjë koalicion me PDK-në, madje jam i sigurt se përmes PDK-në politikisht do të jetë shumë më e shëndetshme të qëndrojë në opozitë. Jam i sigurt se nëse LV-ja do të detyrohet të bëjë koalicion me një parti të madhe shqiptare, para PDK-së gjithmonë do të përcaktohet përmes LDK-në.

3. Është krejtësisht i mundur koalicioni PDK-LDK-AAK dhe pakicat nëse dështojnë koalicionet 1 dhe 2. Këtë po e them nëse janë këto rezultate, në të kundërtën, nëse dalin parashikimet e "Gani Bob - Haxhiu" apo të jahudive, do të luhet një lojë tjetër dhe do të vlejnë "rregullat e Albinit". Në këtë konstelacion të raporteve politike, zgjedhja e presidentit nuk do të provokojë zgjedhje të reja dhe procesi do të përbillyet, qoftë pa Vjosën, qoftë pa Ramushin. Vjosa Osmanin e shoh si kryetare të Kuvendit. Me variantin postmodern të Atifete Jahjagës apo Kurshumliut.

Diskutohet përmes draftet e rregullores komunale përmes menaxhimin e mbeturinave në Gjakovë



GJAKOVË, 9 SHKURT (ER) - Drejtoria e Shërbimeve Publike në Gjakovë, përkatësisht sektori përmes Menaxhimin e Mbeturinave, ka organizuar tjetër martën një punëtori në cilën janë prezantuar dhe diskutuar draftet


e Rregullores Komunale përmes Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plani Lokal përmes Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2025. Dy dokumente këto tejet tjetër rëndësishme përmes zhvillimin e këtij sektori dhe përmirësimin e

mëtejshmë të menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së ambientit në Komunën e Gjakovës. "Nga tjetër pranishmit është konstatuar se situata e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtja e ambientit është duke u

përmirësuar çdo ditë e më tepër dhe se me miratimin e këtyre dy dokumenteve, efikasiteti do të jetë edhe më i lartë", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.

Rregullorja Komunale përmes Menaxhimin e Mbeturinave dha

Plani Lokal përmes Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2026 janë në fazën e diskutimit publik dhe më tej do të kalojnë përmiratim edhe në Kuvendin e Komunës përmes implementimit i tyre në terren.



Prishtina, Llapi dhe Drenica kualifikohen në çerekfinale

Në çerekfinale të Kupës janë kualifikuar Prishtina, Llapi dhe Drenica, të cilat mposhtën Dritën, Ballkanin dhe Ulpianën. Katër klubet e tjera që do të kualifikohen në këtë fazë të Kupës do të mësohen sot (e mërkurë)



EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 SHKURT - FC Prishtina po kalon nëpër një periudhë të mirë sa iu përket rezultateve pozitive. Kjo skuadër vëtëm pak ditë pasi triumfoi në finalen e Superkupës ndaj Dritës, të njëjtën gjë e bëri edhe të martën kur e mposhti skuadrën kampione në fuqi në kuadër të 1/8 së finales së Kupës (1-0). Ndesha u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokri" dhe është dashur që të luhën edhe vazhdimet për t'u nxjerrë fituesi. Rastet gjatë nëntëdhjetë minutave nuk munguan, por gola nuk pati dhe ndeshja shkoi në vazhdime. Më e sukseshtë doli skuadra kryeqytetase që arriti fitore falë golit të Lorik Boshnjakut në minutën e 105-të. Duhet cekur se në fund të ndeshjes, Vuçaj dhe Brdarovski u ndëshkuan me karton të kuq. Prishtina

kualifikohet në çerekfinale të Kupës, kurse Dritës i mbetet ta ndjekë titullin e kampionës.

Ndeshje interesante u zhvillua edhe në stadiumin "Zahir Pajaziti", në mes të Llapit dhe Ballkanit. Skuadra e Tahir Batatinës u kualifikua tutje, pasi doli më e sukseshtë se skuadra suharekase në gjuajtjet e penalltive (4-3). Koha e rregullt dhe vazhdimet u mbyllën me rezultat 0-0. Duhet cekur se myasfirët nga minuta e 77 mbetën pa një lojtari, pasi Luljanović u ndëshkua me karton të kuq. Në penalti për Llapin të saktë ishin Zhrella, Ramadani, Emini dhe Hyseni, kurse për Ballkanin shënuan Daku, Thaqi dhe Gripshi, ndërsa dështuan Mevlana Zeka dhe Visar Berisha.

Çerekfinalen e ka siguruar edhe Drenica nga Skenderaj që triumfoi bindshëm kundër Ulpianës (4-0). Dy gola për skuadrën kuqezi i realizoi Zaberxha,

Kupa e Kosovës - 1/8 e finales

Prishtina - Drita	1-0
Drenica - Ulpiana	4-0
Llapi - Ballkani	0-0

(4-3, pas vazhdimeve)

Të mërkurën takohen:
13:00 A&N - Flamurtari
13:00 Trepça '89 - Ferizaj
13:00 Istogu - Gjilan
13:00 Dukagjini - 2 Korriku

kurse nga një tjetër e shtuan Rapo dhe Uka. Sot (e mërkurë) zhvillohen katër ndeshjet e tjera të 1/8 së finales, kurse vëmendja do të jetë në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Demush Mavraj" në mes të Istogut dhe Gjilanit. Skuadra e Superligës, e cila drejtobhet nga Bylyb Sokoli, llogaritet favorite për t'u kualifikuar në çerekfinale. Dukagjini përballet me 2 Korrikun, kurse në dy ndeshjet e tjera Trepça '89-Ferizaj dhe A&N - Flamurtari.

Mavraj: Dua ta mbylli karrierën në Kosovë

PRISHTINË, 9 SHKURT - Mbrojtësi i njohur shqiptar, Mërgim Mavraj, ka zbuluar një të dhëna të tij. Futbollisti që ka bërë karierë në Bundesliga 1 dhe 2, por edhe në Greqi, dëshiron që karierën ta mbylli në Kosovë. "Normalisht që është më mirë ta mbylli në Bundesligën 1 sesa në të dytën", ka thënë Mavraj. "Por ende

ime është që ta mbylli në kampionatin e Kosovës. Besoj se, pavarësisht se ku do ta përfundojë sezonin Greuther Fürth, vitin e ardhshëm apo më saktë vitet e ardhshme, duke qenë se nuk kam ndërmend ta mbylli karrierën tanë, dua ta përfundoj në Kosovë. E kam ende", ka deklaruar Mavraj për "Panoramasport". Mbrojtësi me



prejardhje nga Istogu mund ta tërheqë vëmendjen e shumë klubeve në Superligë.

SHKURT

Kosova, miqësore me Katarin

Aktivitetin e parë të vitit 2021 Përfaqësuesja U21 do ta zhvillojë në pranverë. Në fakt, më 26 mars "dardanët" e rinj do të përballen me Katarin në kryeqytetin Doha, ndërkohë që ekziston mundësia të zhvillohet edhe një miqësore tjetër tri ditë më pas. Miqësorja me Katarin vjen si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet dy federatave. "Ndonëse ky takim ka kohë që është aranzhuar, gjithçka do të varet nga gjendja me pandeminë. Situata me Covid-19 do ta determinojë edhe praninë e lojtarëve kosovarë të cilët janë të angazhuar në klubet evropiane", thuhet në njoftimin e FFK-së. Në Doha të Katarit do ta ketë debutimin si përzgjedhës i U21, trajneri gjerman Michael Nees, i cili u emërua në këtë pozitë muajin e kaluar. Ai në këtë grumbullim do t'i ketë në dispozicion futbollistët e gjeneratës 2000/2001. Ky grumbullim në Katar do t'i shërbejë Përfaqësueses U21 për t'u përgatitur për ndeshjet kualifikuese të Evropianit 2023, ku bën pjesë në Grupin G së bashku me Anglinë, Republikën e Çekisë, Slloveninë, Shqipërinë dhe Andorrën. Ndeshjen e parë kualifikuese Kosova U21 do ta luajë më 8 qershor si vendase kundër Andorrës.

Rrahmani pritet të jetë titullar kundër Atalantas

Kapiteni i Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, do të luajë nga minuta e parë në ndeshjen e dytë kthyese të gjysmëfinales së Kupës së Italisë, që Napoli e luan ndaj Atalantas. Mbrojtësi i Kosovës do ta ketë rastin të paraqitet në këtë takim pas lëndimit të Kalidou Koulibalyt dhe Kosas Manolasit. Përveç Rrahmanit, në këtë takim do të luajë edhe mbrojtësi Elseid Hysaj. Ndeshja Atalanta - Napoli luhet sonte (e mërkurë) nga ora 20:45. Takimi i parë kishte përfunduar pa gola.

KB Rahoveci ndahet me trajnerin Bujar Loci

Bordi i KB Rahoveci në mbledhjen e fundit të mbajtur pas zhvillimit të "FINAL 8" ka analizuar rrjetdhënët e kampionatit dhe pozicionin aktual të skuadrës sonë në këtë fazë të garave edhe në Superligë. "Pas shqyrtimeve dhe diskutimeve për gjetjen e një rrugëdalje nga këto rezultate, në marrëveshje edhe me trajnerin Bujar Loci, ka vendosur që t'i shkëpusë bashkëpunimit me këtë të fundit", thuhet në njoftimin e Rahovecit. "Bordi ka vlerësuar se skuadra po hyn në një fazë kruciale të kampionatit dhe e ka parë të domosdoshëm këtë veprim. Bordi dëshiron ta falënderoje trajnerin Loci për tërë angazhimin në pjesën e parë të kampionatit pasi, siç dihet, i njëjtë i mori drejtimin e klubit në fazë jo të mirë. Bordi i dëshiron çdo të mirë dhe suksesë në të ardhmen trajnerit Loci, derisa në ditët e ardhshme do të vendoset edhe për kryetrajan e ri", thuhet në njoftimin e kësaj skuadre.

Strakosha: Do të gënjeja nëse do të thosha që nuk më intereson

ROMË, 9 SHKURT - Tomas Strakosha bën një hap drejt largimit nga Lazio. Portieri i Kombëtares kuqezi ka konfirmuar interesimin e Borussia Dortmundit, ekip që ka shprehur dëshirën për ta

pasur në skuadër. Strakosha ka humbur vendin e titullarit te Lazio, që pas rikthimit nga infektimi me Covid-19, ndalesë që u shoqërua më vonë edhe me një lëndim muskular. "Po flasim për një

skuadër të madhe, të rinj shumë të talentuar. Do të ishte interesante të jesh atje, mbi të gjitha në një stadium që tejmbushet dhe me tifozë që dhurojnë një atmosferë spektakolare. Do të gënjeja

nëse do të thosha që nuk më intereson. Sinquerisht, kush nuk do të tundohej nga një ofertë e tillë", janë fjalët e gardianit Strakosha i intervistuar nga media gjermane "Sky Sport".



Lakersat marrin fitoren e pestë rresht, nuk ndalet as Bucksi

OKLAHOMA, 9 SHKURT - Los Angeles Lakers mundi skuadrën e Oklahoma City Thunderit për t'u rikthyer të vetëm në vendin e dytë të Konferencës së Perëndimit. Një fitore tepër e vështirë, e siguruar vetëm pas kohës shtesë, që i barazon kampionët në fuqi për nga numri i fitoreve me ekipin e Utah Jazzit. Franchise nga "Salt Lake City" e ka ngritur stekën vërtet shumë lart, duke fituar 15 nga 16 sfidat e fundit, për t'i shtrënguar në këtë mënyrë dy ekipe nga Los Angelesi që ta shtojnë ritmin, raporton "Supersport". Një rivalitet i fortë, në një pjesë të rëndësishme të sezontit të rregullt, kur skuadrat kanë hyrë prej shumë ditësh në çerekun e dytë të këtij edicioni të 75, për sa i përket sezontit të rregullt. Mbi të gjitha, kalendarit sa vjen e njëjshët dhe pasojat duken qartë edhe të vetë ekipi i drejtuar nga trajneri Frank Vogel, që siguroi fitoren e dytë radhazi pas kohës shtesë. Për "ligenorët" ky është suksesi i pestë rresht, në këtë pjesë të sezontit dhe i treti radhazi në shtëpi. Kështu, pasi mundi të premten Denver Nuggetsin, Lakersi imposhti të dielën në mbrëmje në kohën shtesë 135-129 Detroit Pistonsi. Radhën për të vizituar në Staples Center kampionët në fuqi e patën basketbollistët e Oklahomas, të cilët u paraqitën në Kaliforni me bilancin negativ, 10 fitore në 21 ndeshjet e deritanishme të sezontit të rregullt. City Thunderi pozicionohet vetëm në vendin e tretë nga fundi në Konferencën e Perëndimit, megjithatë duke lënë mënjanë dy goditjet e sakta të Lakersat në çastet e para të takimit nga vija e gjuajtjeve të lira skuadra e Oklahomas dominoi në rezultat përgjatë gjithë pjesës së parë, duke u shkëputur madje deri në +11, me shifrat 33-22. Në interval miqtë shkuan me epërsinë 60-56, ndërsa avantazhin e parë që nga starti i ndeshjes Lakersat e morën në fillimin e periodës së tretë. Kampionët në fuqi krijuan madje edhe një diferençë prej 7-pikësh me Thunderin, por



gjithsesi skuadra e Oklahomas reagoi shpejt për të flutuar në startin e periodës së fundit sërisht në epërsinë e 11 pikëve, 90-79. Me shumë mundim vendësit ia dolën mban për të rikuperuar, sidoqoftë 1,2" para fundit 22-vjeçari kanadez Shai Gilgeous-Alexander barazoi rezultatin nga vija e gjuajtjeve të lira në 110-110, për të shtyrë gjithçka për në kohën shtesë. Në kohën shtesë, Lakersat kaluan shpejt përpëra, megjithatë ishte një 5' tëpër i shtrënguar, ku dominuan përgjithësisht mbrojtjet. Në 2' e para u shënua vetëm një kosh nga ekipi i Frank Vogel, megjithëse për hir të së vërtetës në krahun tjetër skuadra e Oklahomas e mbylli gjithë kohën shtesë me vetëm 2 pikë gjithsej. Lakersat fituan 9-2 në kohën shtesë dhe falë suksesit 119-112 regjistruan fitoren e 19 në 25 ndeshjet e zhvilluara deri tanë. Në konferencën e Perëndimit edhe Utah për momentin ka 19 fitore, por gjithsesi Jazzi kryeson me një përqindje më të mirë, për shkak se kanë pësuar një humbje më pak sesa Lakersit. Mbreti Jamesi e mbylli mbrëmjen përsëri me triple-double. LeBron e përfundoi takimin me 28 pikë, 14 topa të rikuperuar dhe 12 asistime, ndërkohë pikëshënesi më i mirë i ndeshjes ishte 22-vjeçari nga Ontario Gilgeous-Alexander me 29 pikë, sidoqoftë basketbollisti nga Toronto regjistroi gjithash tu edhe 7 rebounë e 10 asistime. Ekipi i vetëm që nuk njeh humbje në 5 sfidat e fundit.

Në Colorado, në Ball Arena të Denverit Bucks e morën kryesimin në periodën e tretë, kur basketbollistët e franchiset nga Wisconsin shënuan plot 15 pikë radhazi. Në vazhdim ekipi i drejtuar nga trajneri Mike Budenholzer u shkëput përfundimisht, për të fituar gjithë takimin me shifrat 125-112, ndeshje ku më i miri për miqtë ishte i zakonshmi Giannis Antetokounmpo me 30 pikë e 9 rebounde, në diçka më shumë se 34' lojë, ndërsa te Nuggetsi spikati sërisht kapiteni Nikola Jokiqi me 35 pikë e 12 topa të rekuperuar. Suksesi i pestë rresht i mban Bucksit në vendin e dytë në Lindje, me 16 fitore e 8 humbje, thjesht një fitore më pak sesa Philadelphia 76ers, që kryesojnë prej kohësh në këtë konferencë. Luka Doncic realizoi 26 pikë për të ndihmuar Dallas Mavericksit në "American Airlines Center" përpëra 1 000 spektatorëve, në fitoren 127-122 ndaj Minnesota Timberwolves dhe ylli slloven tani e sheh veten vetëm 2 ndeshje larg rekordit të franchiset teksan, teksha ka shënuar minimalisht 25 pikë në 11 ndeshjet e fundit të Mavsit. Figurë të mirë bëri edhe ekipi tjetër teksan i San Antonio Spursit, që në "AT&T Center" përmbysi disavantazhin e plot 14 pikëve për të mposhtur 105-100 skuadren e Golden State Warriorsit, duke eklipsuar në njëfarë mënyre edhe lojën shumë të mirë të organizatorit të miqve Steph Curry, që realizoi 32 pikë në 36' që qëndroi gjithsej në parket.

Edhe tre të dyshuar për vdekjen e Maradonës

BONUES AIRES, 9 SHKURT - Është thelluar skandali për vdekjen e Diego Armando Maradonës. Hetimet për zbardhjen e shkaqeve që sollën humbjen e jetës së legjendës argentinase po zgjerohen gjithnjë e më shumë.

Mediat argentinase bëjnë me dije se pesë persona po hetohen nga prokurori i përgjithshëm i San Isidros, që po merret apostafat me këtë çështje. Pas doktorit Leopoldo Lukue dhe psikiatres Agustina Kosaçov,

zbulohet se po hetohen gjithashtu edhe psikologu Karlos Diaz dhe infermierët Ricardo Almiron dhe Dahiana Gisela. Të tre këta të fundit akuzohen për dëshmi të rreme përmarrjen në pyetje pas ndarjes ngajeta të

Diegos. Karlos Diaz, me profesion psikolog, ishte kujdesur për Maradonën në shtator 2020 dhe u pa me dyshim nga prokurorët për rolin që ai kishte mbajtur, ndërkohë Ricardo Almiron ishte i fundit që e pa Maradonën të

gjallë para se të pësonte sulm në zemër. Sipas të gjitha gjasave, tre të dyshuarit e rinj do të thirren përsëri nga hetuesit në ditët në vijim për t'u marrë në pyetje, pëtë hedhur drithë mbi të vërtetën e humbjes së jetës së Diegos.

SHKURT

Suarezi thyen rekordin e Ronaldos

Forma e shkëlqyer e Luis Suarezit tek Atletico Madridi ka vazduar edhe të hënën mbrëma kur shënoi dy gola kundër Celta Vigos. Sulmuesi uruguayan në këtë mënyrë e ka thyer një rekord të Cristiano Ronaldos nga koha kur luante te Real Madridi. 34-vjeçari shënoi nga një gol në seicën pjesë në Wanda Metropolitano, në takimin të cilin skuadra lidere e përfundoi me barazim (2-2). Suarezë është golashënesi më i mirë në La Liga aktualisht, me 16 gola të shënuar në vetëm 17 paraqitje në La Liga. Ish-sulmuesi i Barcelonës është lojtari i parë që shënon 16 gola në 17 ndeshjet e para për një skuadër në elitin e futbollit spanjoll në shekullin 21. Statistikën më të mirë të mëparshme e ka pasur Cristiano Ronaldo, i cili shënoi 15 gola në numër të njëjtë ndeshjes, pas transferimit nga Manchester Unitedi te Real Madridi në vitin 2009.

City, gati 110 milionë euro për Kimmichin

Manchester City është gati të ofrojë rreth 110 milionë euro për Joshua Kimmich këtë verë, njofton "Don Balon". Trajneri spanjoll i Cityt, Pep Guardiola, është një tifoz i madh i mesfushorit gjerman. 26-vjeçari ka një kontratë deri në vitin 2023 (30 qershor) me kampionët e Evropës dhe Gjermanisë. Në anën tjetër pak besohet se Bayern Müncheni mund ta shesë Kimmichin, i cili shihet si kapiten i ardhshëm i klubit.

Ibra dëshiron të luajë me Suedinë

Nuk luan me Suedinë që në vitin 2016 kur humbte minimalisht ndaj Belgjikës, por mund të rikthehet në një moment shumë kulminant, Evropianin e vërvës së ardhshme. Mediat italiane janë të bindura për këtë. Zlatan Ibrahimoviqi pritet të vendosë t'i bashkohet kombëtares në verë, pavarësisht se më parë duhet t'i zgjidhë mosmarëveshjet me trajnerin Andersson. Ky i fundit në të shkuarën është shprehur qartë se nëse Ibrahimoviqi i shpreh qartë dëshiron për t'u rikthyer, ai është gati ta mirëpresë në ekipin verdheblu.

Pas Ramosit edhe Varane refuzon rinovimin me Realin

Reali i Madridit mund të mbetet në afatin kalimtar të verës pa dy mbrojtësit kryesorë Sergio Ramos dhe Raphael Varane. Pas Ramosit, edhe Varane nuk dëshiron që ta rinovojë kontratën që i skadon në vitin 2022 me Realin. Drejtuesit e klubit nga Madridi në listë kanë David Alaben e Bayern München, Pau Torres e Villarealit dhe Diego Carlos e Sevillas.

Di Maria mungon ndaj PSG-së

PSG-ja do të jetë pa Angel Di Maria në ndeshjen kundër Barcelonës në "Camp Nou". Argentinasi pësoi lëndim në fitoren ndaj Marseille dhe trajneri Mauricio Pochettino nuk do ta ketë në disposicion për një kohë, edhe pse lëndimi nuk është serioz. Sipas RMC Sport, "Parisienët" nuk do të rrezikojnë Di Marian, andaj nuk do të jetë i pranishëm kundër katalunasve. Sidoqoftë, mesfushori Marco Verratti, pavarësisht prej lëndimit, pritet të jetë i gatshëm ndaj Barcelonës. Ndesha e dytë mes PSG-ja dhe Barcelonës zhvillohet në "Parkun e Princave" në muajin mars.



TrafikuUrban

KONKURS

Pozita - "Zyrtar për Kamerat e GPS"

Numer i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjata e punës: 1 vit me mundësi vazhduimi

Orari i punës: I plotë.

Detyrat dhe përgjegjësia

- Monitoron, kontrollon dhe miremban kamerat e GPS-at në autobusë.
- Bën regjistrimin dhe identifikimin e problemeve të cilat paraqiten në incizimet e kamerave e GPS-vës,
- I njerëzi reportet, problemet të cilat paraqiten gjatë orrit të operimit dhe i ruani ato nga kamerat e GPS.

Kualifikimeve dhe aftësia

- Shkollimi i lartë: TIK, Management e Informatikës, Shkencat Kompjuterike ose të ngjashme nga fushat teknike;
- Njohuni e qasjeve moderne në planifikim dhe kontroll;
- Aftësi kompjuterike posaçëriat mbi sistemet kompjuteake me kamerat e GPS;
- Njolja e gjithës angleze është e nevojshme;
- Përvaja e punës me përparrësi;
- Gatishmëri për të punuar natën se pse është specifike mirembajtja e autobusëve gjatë nderrimit të 3-të.

Dokumentacioni i nevojshëm është i mënyrës së aplikimit:

- Kandidatimi, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skannuar në email: punesimi@trafikuurban-pr.com:
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikuurban-pr.com/shqjob-aplikacioni-shq.html>)
- Dëshmuri mbi shkollim;
- Dëshmuri mbi përvajën e punës (nëse ka);
- Kopja e letërmësimit;
- Dëshmuri nga Gjykata që nuk është nën hetime më të re se 6 muaj;
- Dëshmuri mbi patentë shoferin.

Konkursi është hapur 15 ditë nga data e publikimit, nga 10.02.2021 deri më 24.02.2021.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "B.O.M" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810108185 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.


OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "B.O.M" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810108185, ujedno imenovaao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljuvanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "B.O.M" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 810108185, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[facebook](https://www.facebook.com/gjejpuneshpjete)  www.facebook.com/gjejpuneshpjete

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

- Ibrahim Sylejmani shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I-VIII, SH.F. "Ilirja" Pogradj.
- Armond Xhemaj shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Sokol Quaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.
- Rahid Dzaferi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Hilmi Emini shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Agim Morina shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Fatmir Xhaferi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Dëshmorët e Kabashit" Korishe.
- Dardan Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.
- Ramsel Bajrami shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Mushnikova" Mushnikov.
- Jap banës me qira afër 60 m2, katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katë i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katë i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banës me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Me rastin e dhjetë vjetorit
të ndarjes ngajeta



HAFİR ABAZ THAÇI

(1961 – 2011)

I dashuri dhe i shtrenjti ynë për jetë:

Malli për ty po rritet!
Dhimbja është po aty!
Krenaria që të patëm të tillë është gjithmonë brenda nesh e po
na mbanë të fortë për të përballuar humbjen tënde!

**Me mall, dhembje e krenari e përkujton familja e gjerë Thaçi
nga Mirusha.**



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike „Ibër-Lepenc” SH.A. Prishtinë, Publikon këtë

NJOFTIM

- Anulohen pozitat në Konkursin e shpallur me datën 12.01.2020, në gazetën "Epoka e Re", me të cilin eshtë kërkuar:
Inxhinier i Gjeodezisë dhe i Sistemit Gjeografik të Informimit (S.G.J.I.) (1), Inxhinier i Bujqësisë në Nj.Punuese "Vushtri" (1), Referent i dokumentacionit teknik të objekteve (1), Elektromonter(1), Drejtues i automjetit(1), Axitatorë(1), Pastrues/ Punëtor i higjienës në Nj.Punuese "Vushtri"(1)
- I falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit në Konkurs.

KRYESHEF EKZEKUTIV

Berat Lushtaku

NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Ligji Nr. 06/L -016, konform nenit 112 paragrafi 1,2,3,4 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Rent A Car Meha Sh.p.k. me numër unik identifikues (NUI) : 811280205 me seli në Vragoli, Komuna Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin dhe ka caktuar likuidatorin Arlind Dervisholli me ID: 1230721021 nga Fushë Kosova, Adresa: Fshati Vragoli Mahalla e lart nr.10 me tel: 049/605-630 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të parealizuara dhe raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
SPORT MARKETING PRISHTINË

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, NPL "Sport Marketing" shpallohet:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i pozitës: Zyrtar/e për Arkivë

Nr. i referencës: NPL/KES

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Vendi i punës: Rr. Sylejman Vokshi, nr. 5/A, 10000, kati i parë 10000 Prishtinë, Kosovë.

Detyrat dhe përgjegjësítë:

- merr në dorëzim dhe dërgon korrespondencën, e cila i drejtohet NPL-së dhe dërgohet prej saj;
- siguron që dokumentacioni që hyn në institucion të shpërndahet brenda ditës me qëllim që stafi të realizojë detyrat brenda afateve të caktuara duke kryer shënimet në regjistrat apo librat përkatës të dorëzimit;
- bën kopje dhe shumëfishim të dokumenteve dhe i shpërndan ato sipas porosisë në destinacionet e caktuara me qëllim njohjen me dokumentacionin nga ana e punonjësit të cilët i adresohet për ndjekje shkresa;
- siguron që shkresat e dala nga institucioni të shkojnë në destinacionin e caktuar duke ndërmarrë shënimet përkatëse në librin e postës;
- identifikon, etiketon dhe klasifikon regjistrimet për ruajtjen fizike, me qëllim të lehtësojë aksesin dhe menaxhimin e arkivës;
- eshtë përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e punës në aktivitetin e arkivës;
- menaxhon përdorimin e vulës së NPL-së në mënyrë të kujdeshshme dhe strikte;
- kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryeshefit ekzekutiv dhe Sekretari në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda objektivave të punës.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

I përgjigjet për punën e tij/saj: Sekretarit dhe Kryeshefit ekzekutiv.
Përgatitja shkollore: PMSH (përgatitje e mesme shkollore)
Përvoja e punës: 1 vit në punë administrative.

Informatë për procedurën e konkurimit

Aplikantët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:

- Aplikacionin e plotësuar.
- CV e aplikantit.
- Dëshminë e kualifikimit shkollor.
- Dëshminë mbi përvojën e punës, referencat si dhe certifikata tjera profesionale.
- Certifikatën nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (Valide).
- Dokumentin e identifikimit - letërnjofte i fotokopjuar.
- Letër Motivuese për pozitën të cilën aplikoni.

Konkursi eshtë i hapur 15 ditë kalendare nga dita e publikimit në faqet zyrtare të NPL "Sport Marketing", si dhe në gazetat ditore, duke filluar nga data **09.02.2021** deri me datë **23.02.2021** si datë e mbylljes së konkursit. Aplikantët e interesuar kërkesën për aplikim me dokumentacion të rregullt, duhet ta paraqesin në zyrat e NPL SPORT MARKETING SH.A. Rr. Sylejman Vokshi, nr. 5/A, 10000, kati i parë 10000 Prishtinë, Kosovë. Email: info@nplsportmarketing.com në Prishtinë, çdo ditë pune prej orës 8:00 – 16:00. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes numrit të telefonit: 038 704-799.



An advertisement for RC Cola. At the top, the RC logo is displayed with the text 'ROYAL CROWN' above it. Below the logo, a yellow box contains the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS'. To the right, there are images of a blue RC can and a dark plastic bottle of RC Cola. On the left, a dark blue sidebar lists 'Quality & Sales Award Recipients' in yellow text, with a note '(Listed in alphabetical order)' in smaller text below. The recipients listed are: ARC Refreshments Corporation - Antipolo Philippines, Quality; Embotelladaora Central S.A. Paraguay, Quality; Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality; Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality; Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality; Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales; Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality; Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality; Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality; Soft Drinks Georgia Georgia, Sales.